



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË



HAPET THIRRJA PËR REGJISTRIM NË PROGRAMIN E DOKTORATËS "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË RAJONIN E BALLKANIT"

DOKTORATË E DYFISHTË

Program i përbashkët studimi i ciklit të tretë, në bashkëpunim ndërmjet Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, dhe West University of Timișoara, Rumani

VITI AKADEMIK 2026–2027

Afati i aplikimit: **4 shtator 2026 - 25 shtator 2026**

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR T'U PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS

Programi i doktoratës "Studime gjuhësore dhe etnokulturore në rajonin e Ballkanit", pranë Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë, synon përgatitjen e studiuesve të rinj në fushat përkatëse të kërkimit shkencor.

Për t'u pranuar në programin e doktoratës, kandidati duhet të përmbushë kriteret themelore të pranimit, si më poshtë:

- a. Të zotërojë diplomë "**Bachelor**" ose ekuivalente me të, në fushën përkatëse të studimit.
- b. Të zotërojë diplomë "**Master i Shkencave**" ose ekuivalente me të, në fushën përkatëse të studimit.
- c. Fushat e kërkimit janë:
 1. Gjuhësi;
 2. Letërsi;
 3. Etnologji;
 4. Studime kulturore.
- d. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të ekuivalentuara përpara aplikimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- e. Të ketë mesatare të ponderuar të notave jo më të vogël se 8 (tetë) në ciklin e parë të studimeve (diplomë Bachelor ose ekuivalente me të) dhe në ciklin e dytë të studimeve (Master i Shkencave ose ekuivalente me të), përfshirë programet e integruara të nivelit të dytë.
- f. Të dëshmojë njohjen e njërës prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, në **nivelin B2**, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

g. Në rast se kandidati ka përfunduar një program studimi në një nga pesë gjuhët e huaja të përmendura më sipër, diploma e përfutur mund të shërbejë si dëshmi për plotësimin e kriterit të njohjes së gjuhës së huaj.

h. Diploma e fituar në një program studimi në universitetet rumune përbën avantazh për kandidatin.

i. Të plotësojë kriteret e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për pranimin në programet e studimeve të ciklit të tretë.

j. Kandidati duhet të ketë përvojë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në një nga disiplinat që lidhen me fushat e parashikuara në këtë program doktorate.

k. Të paraqesë dy rekomandime nga personel akademik që mban titullin akademik **“Profesor”** ose **“Profesor i asociuar”**, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidetit.

l. Kandidatit të mos i jenë marrë masa disiplinore dhe të mos jenë konstatuar shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo të rregullave kundër plagjiaturës. Kandidati duhet gjithashtu të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

m. Të marrë përsipër përmbushjen dhe respektimin e standardeve shkencore, akademike, ligjore dhe etike, si dhe të kërkesave të tjera të përcaktuara nga programi i studimit dhe legjislacioni në fuqi.

n. Kandidati duhet të ketë veprimtari hulumtuese dhe kërkimore-shkencore në një nga fushat ose nënfushat e parashikuara në programin e studimit të doktoratës **“Studime gjuhësore dhe etnokulturore në rajonin e Ballkanit”**, si dhe veprimtari të tjera akademike të lidhura me objektin e programit të studimit dhe punime shkencore treguese.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Në programin e doktoratës mund të aplikojnë:

- Persona të cilët, për shkak të statusit të tyre të punësimit si personel akademik në institucionet e arsimit të lartë (IAL), kanë detyrim ligjor për të vijuar kualifikimin në nivelin e tretë të studimeve;
- Personel akademik i punësuar me kohë të plotë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli”;
- Personel akademik i punësuar me kohë të pjesshme në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli”;
- Personel akademik nga fakultete ose njësi akademike të ngjashme të universiteteve publike dhe jopublike;
- Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike ose jopublike, të angazhuar në veprimtari kërkimore ose zbatuese, veprimtaria e të cilëve lidhet me fushat e kërkimit të njësive bazë që ofrojnë programin e doktoratës.

AFTËSITË E PREFERUARA TË KANDIDATËVE

Preferohen kandidatët që dëshmojnë aftësi dhe kompetenca të lidhura me:

- Kompetencë të lartë shkencore dhe aftësi për të zhvilluar kërkim të pavarur;
- Zhvillimin e mendimit kritik dhe të aftësisë për të analizuar në mënyrë të thelluar çështjet që lidhen me fushën e kërkimit;
- Aftësi për të integruar fusha të ndryshme të kërkimit, duke krijuar qasje ndërdisiplinore në trajtimin e problematikave shkencore;

- Aftësi për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që mund të shfaqen gjatë procesit të kërkimit shkencor;
- Aftësi për të menaxhuar kompleksitetin e procesit kërkimor dhe për të propozuar ide, qasje dhe perspektiva të reja në fushën e kërkimit, të cilat do të vlerësohen nga komisioni përgjegjës gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në programin e studimeve të doktoratës me dosje individuale.

Dosja e aplikimit, e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, dorëzohet vetëm nëpërmjet shërbimit postar, në adresën:

Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

Zyra e Protokoll Arkivit

Shëtitörja “Rilindasit”,

Korçë, Shqipëri, 7001

Kandidati është përgjegjës për dërgimin e dosjes së plotë të aplikimit brenda afatit të përcaktuar. Universiteti “Fan S. Noli” nuk mban përgjegjësi për vonesat, humbjet, dëmtimet apo problematika të tjera që mund të lindin gjatë procesit të dërgimit të dokumentacionit nëpërmjet shërbimit postar.

Për këtë arsye, kandidati duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që dosja e aplikimit të mbërrijë pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit brenda afatit të përcaktuar për aplikim.

Kërkesa për pranimin në programin e doktoratës dhe dosja e aplikimit, me dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj thirrjeje, i drejtohen njësisë bazë përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës dhe duhet të përmbajnë dokumentet e mëposhtme:

- a) Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës, ku të përcaktohen fusha e studimit të doktoratës që kandidati kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
- b) Deklaratën e drejtuesit shkencor për marrjen përsipër të udhëheqjes së studimeve të doktoratës në fushën e përzgjedhur;
- c) Projektpropozimin për temën e kërkimit, metodologjinë dhe pritshmëritë e studimit, të nënshkruar nga drejtuesi shkencor;
- d) Letër motivimi;
- e) Jetëshkrim (CV);
- f) Listën e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla;
- g) Kopje të noterizuara të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomave ose listat e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes ose të ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;

h) Kopje të noterizuara të diplomave të ciklit të tretë, “Master Ekzekutiv”, diplomës së specializimit ose diplomave të tjera ekuivalente me to, të shoqëruara me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati i disponon;

i) Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës;

j) Dëshmi penaliteti, të lëshuar brenda tre muajve të fundit përpara datës së aplikimit;

k) Dy fotografi;

l) Dy rekomandime nga persona që mbajnë titullin akademik “**Profesor**” ose “**Profesor i asociuar**”, ku të paktën njëri prej rekomanduesve duhet të jetë nga fusha përkatëse e kërkimit shkencor;

m) Vetëdeklarim, nëpërmjet të cilit kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të lidhura me studimet e doktoratës, sipas përcaktimeve të Universitetit “Fan S. Noli”;

n) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj, në përputhje me nenin 78 të ligjit nr. 80/2015. Dëshmia duhet të jetë për njërën prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, në nivelin e kërkuar dhe të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin;

o) Vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;

p) Mandatpagesën për tarifën e aplikimit;

q) Vetëdeklarimin e aplikantit se do të respektojë dhe zbatojë standardet shkencore dhe etike;

r) Projektpropozimin për studimet e doktoratës, si pjesë e dokumentacionit të aplikimit;

s) Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentacionin e plotë të përcaktuar më sipër nuk do të shqyrtohen.

Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit, aplikantit i lëshohet një vërtetim për marrjen në dorëzim të dosjes.

PROCEDURA E REGJISTRIMIT PRANË WEST UNIVERSITY OF TIMIȘOARA PËR KANDIDATËT QË SYNOJNË PËRFITIMIN E DIPLOMËS RUMUNE

Kandidatët që synojnë të përfitojnë edhe diplomën e lëshuar nga West University of Timișoara (UVT) duhet të kryejnë edhe procedurën e aplikimit dhe regjistrimit pranë këtij universiteti, në përputhje me rregulloren dhe kërkesat e UVT-së, të cilat gjendet duke klikuar linkun: <https://doctorat.uvt.ro/en/doctoral-studies/admission/>

Regjistrimi në sistemin e UVT-së duhet të përfundojë brenda datës 7 shtator 2026, së bashku me ngarkimin e dokumentacionit të kërkuar nga universiteti në platformën:

<https://admitereonline.uvt.ro/auth/login>.

Përfitimi i diplomës rumune kushtëzohet nga regjistrimi i rregullt pranë West University of Timișoara, përmbushja e kërkesave akademike dhe administrative të përcaktuara nga ky universitet, si dhe respektimi i kushteve të parashikuara në marrëveshjen ndër-institucionale ndërmjet dy universiteteve.

SI DO TË PËRZGJIDHEN KANDIDATËT?

§ Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Komisioni *ad hoc*, mbi bazën e vlerësimit të dosjes së aplikimit dhe të kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim.

§ Komisioni *ad hoc* është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve, duke përcaktuar paraprakisht kriteret dhe nënkriteret e vlerësimit, mënyrën e pikëzimit, peshën që zë secili kriter në vlerësimin përfundimtar, si dhe mënyrën e llogaritjes së rezultatit dhe të renditjes së kandidatëve. Metodologjia dhe kriteret e vlerësimit bëhen publike përpara fillimit të procesit të vlerësimit, në mënyrë që çdo kandidat të jetë i informuar paraprakisht për mënyrën e zhvillimit të procesit të përzgjedhjes.

§ Pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit dhe, kur kjo parashikohet në metodologjinë e miratuar dhe të bërë publike paraprakisht, Komisioni *ad hoc*, në funksion të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, mund t'i kërkojë aplikantit t'i nënshtrohet një interviste ose testimi, si dhe të paraqesë dokumentacion shtesë të përcaktuar paraprakisht në kriteret e aplikimit.

§ Në përfundim të procesit të vlerësimit, Komisioni *ad hoc* harton renditjen përfundimtare të kandidatëve, sipas pikëve të fituara. Çdo kandidat ka të drejtë të njihet me rezultatin e vlerësimit të tij, me pikët e përfituara sipas kriterëve të përcaktuara dhe me pozicionin e tij në renditjen përfundimtare, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

§ Kandidati që nuk shpallet fitues ka të drejtë të aplikojë përsëri, duke filluar nga viti akademik pasardhës.

FUSHAT KRYESORE TË KËRKIMIT

Programi i studimit të ciklit të tretë, “Doktoratë” në “Studime gjuhësore dhe etnokulturore në rajonin e Ballkanit”, do të realizohet mbi bazën e tre projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimore për studentët shqiptarë brenda vendit, të cilat i përgjigjen më së miri qëllimit të programit për formimin e studiuesve dhe kërkuesve të rinj, të aftë për të zhvilluar kërkime dhe hulumtime të mirëfillta shkencore në fushat e gjuhësisë, letërsisë dhe etnokulturës, duke:

- përdorur qasje teorike dhe metodologji shkencore bashkëkohore për trajtimin e çështjeve kërkimore;
- integruar teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave;
- thelluar dhe specializuar njohuritë në fushat e gjuhësisë, letërsisë, etnologjisë dhe kulturës, si fusha thelbësore në kontekstin e sotëm shoqëror, të karakterizuar nga globalizimi, ndërkombëtarizimi dhe ndërkulturaliteti;
- njohur dhe rekomanduar për doktorantët mjetet dhe qasjet metodologjike kryesore, të cilat do t'u mundësojnë zhvillimin e kërkimeve në fushat përkatëse studimore, si dhe përvetësimin e metodave, teknologjive dhe shprehive të punës kërkimore-shkencore origjinale;
- nxitur doktorantët të realizojnë analiza të thelluara, kritike dhe të argumentuara në fushat përkatëse të kërkimit;
- nxitur kërkimet dhe studimet përfaqëse me karakter zbatues.

PROJEKTET:

Me Vendim të Senatit Akademik nr. 276 datë 19.06.2026 për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve për programin e përbashkët të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “*Studime gjuhësore dhe etnokulturore në rajonin e Ballkanit*”, projekte e miratuara për vitin akademik 2026-2027 për studentë shqiptarë brenda vendit janë 3 (tre):

Nr	Projekti doktoratë i propozuar	Personeli akademik	Lloji i angazhimit
1	Figura e gruas në baladat shqiptare dhe ballkanike: mes mitit, sakrificës dhe kujtesës kulturore	Prof. as. dr. Jonela Spaho	Me kohë të plotë
2	Poetika e absurdit dhe fantastikja në letërsinë moderne ballkanike	Prof. as. dr. Eris Rusi	Me kohë të plotë
3	Terminologji, klasifikim dhe ideologji në hulumtimet e studiuesve gjermanishtfolës mbi rumunët dhe arumunët	Prof. as. dr. Daniela Stoica	Me kohë të plotë

Mbi bazën e këtyre projekteve propozohen (nën)fushat për projekt-propozimet e kandidatëve për doktorantët. Në funksion të realizimit të projektit, do të bashkërendohet më pas edhe programi individual i doktorantit, i cili do të ngërthejë veprimtari kërkimore-shkencore dhe krijuese, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës (disertacionit).

KONTAKT: Prof. as. dr. Eris Rusi, koordinator i programit

Email: erusi@unkorce.edu.al

**Adresa: Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
Shëtitore “Rilindasit”
Pranë Pallatit të Sportit , Korçë, Shqipëri.**